Kronikë

Hani i Hotit/ 72-vjeçari ikën me shpejtësi për të mos u kontrolluar, arrestohet nga policia! Me armë e 17 mijë euro me vete

Një 72-vjeçar, i cili ka qenë duke u futur në Shqipëri nga pika e kalimit kufitar Hani i Hotit është arrestuar nga policia pasi mbante armë në vete. Në përpjekje për të shmangur kontrollin nga pala malazeze, 72-vjeçari Faruk Sekja është larguar me shpejtësi dhe është futur në territorin e vendit tonë.

Eurot dhe armë e sekuestruar

Redaksia
3 Shkurt, 10:39 | **Përditësimi: 3 Shkurt, 11:17**

Share

SHKODËR- Një 72-vjeçar, i cili ka qenë duke u futur në Shqipëri nga pika e kalimit kufitar Hani i Hotit është arrestuar nga policia pasi mbante armë në vete. Në përpjekje për të shmangur kontrollin nga pala malazeze, 72-vjeçari Faruk Sekja është larguar me shpejtësi dhe është futur në territorin e vendit tonë.

> *"Në PKK Hani i Hotit, në territorin e Malit të Zi, në dalje për në Shqipëri, shtetasi Faruk Sekja, i cili drejtonte një automjet tip "Benz", nuk ka ndaluar për të kryer proceduat për hyrjen në Shqipëri dhe është larguar me shpejtësi duke u futur në territorin shqiptar, në PKK Hani i Hotit", njofton policia.*

Ai ka tentuar të fshehë armën e zjarrit pistoletë mbrapa një ndërtese në pikën e kalimit, por është kapur nga policia. Ndërkohë, gjatë kontrollit që efektivët e Policisë Kufitare i kanë ushtruar në automjet, i kanë gjetur të fshehura edhe 17 640 euro, të ndara në disa pjesë.

LEXO EDHE:
Pjesë e një grupi kriminal që trafikuan 3.4 tonë kanabis në Itali, pranga 31-vjeçarit në Malësi të Madhe

> *"Drejtuesi i automjetit, shtetasi F. S., ka dalë nga automjeti dhe ka tentuar të fshehë armën e zjarrit pistoletë mbrapa një ndërtese në pikën e kalimit, por është gjetur dhe sekuestruar nga shërbimet e Policisë Kufitare shqiptare. Gjatë kontrollit të përbashkët me homologët e Malit të Zi, shërbimet e Policisë Kufitare i gjetën këtij shtetasi, të fshehura në automjet, edhe një shumë prej 17 640 eurosh, të ndarë në disa pjesë", njofton policia.*

I moshuari rezulton me precedentë të mëparshëm penal për armëmbajtje pa leje. Ndaj tij rëndojnë veprat penale "Trafikimi i armëve dhe municionit", "Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë", "Pastrimi i produkteve të veprës penale" dhe "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë".

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Shkodër Faruk Sekja

Komento

Komente

Selamiu: 03/02/2024 11:34

Se mos e ka për herë të parë ky

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Deklaratat publike të Arben Ahmetajt i konsideroni:

Të besueshme Kërkon azil S'e di

Lajme të tjera

Zgjidhet kryetari i ri i Këshillit të qarkut Shkodër pas dorëheqjes së Marina Duhanit, Edmond Ndou mori 19 vota pro dhe një kundër

Ergys Kavaja

1 Shkurt, 16:04

Në kërkim për kanosje, ndalohet 29-vjeçari në Shkodër

1 Shkurt, 12:34

PSD bashkon votat me PS në Këshillin Bashkiak të Shkodrës, miratohet harta e hapësirave publike në plazhin e Velipojës! Debat për teatrin 'Migjeni'

Ergys Kavaja

1 Shkurt, 10:01

'Thirrje për të mbrojtur diversitetin', pamje nga vepra e artit në Koplik e artistit kinez Rowang

1 Shkurt, 09:11

Ndoc Fusha rrëfehet në 'Një nga ne': Nëna, arsyeja pse u ktheva nga emigrimi! Në fshatin Bardhaj krijova një mini-muze etnografik

Xhensila Nako

31 Janar, 20:45

Shkodranët zgjedhin ngrohjen me energji, nuk na lëverdis me dru

Ergys Kavaja

31 Janar, 17:11

PS kishte gati shkarkimin, jep dorëheqjen kryetarja e këshillit të qarkut në Shkodër nga radhët e PSD-së së Tom Doshit! Ja emri i ri i socialistëve

Ergys Kavaja

30 Janar, 09:11

"247 persona në kërkim, një pjesë fshihen në Shkodër! Balla lë porositë:Të zbardhen ngjarjet e vjetra pas 1992! Jepini fund bajraqeve, feudeve

29 Janar, 11:35

EMRI/ Arrestohet në Belgjikë 30-vjeçari nga Shkodra! Në korrik 2023 kërcënoi me armë të riun

29 Janar, 09:53

Dhunoi bashkëshorten, arrestohet 38-vjeçari në Pukë

28 Janar, 10:49

Teatri 'Migjeni' drejt shkrirjes? Reagon drejtori Arjan Çuliçi: Jemi në kulmin e provave! Reagon dhe kryetari i bashkisë

27 Janar, 14:11

Aksidenti Shkodër - Velipojë ku humbi jetën 4 vjeçari, policia dyshon se shoferja 22 vjeçare shkeli regullat e qarkullimit rrugor

26 Janar, 11:09

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet ripërdhimi i paautorizuar i kesaj faqeje